

LAVDOSH ISUFI

MERGIMTARI

poezi

**Kete liber ja dedikoj kujtimit te prinderve te mi
dhe familjes time.**

**Gruas, vajzes dhe djalit, qe kan qene e do te
mbeten frymezusit e mi shpirteror...**

Parathënie

Kurbeti ka qënë dhe mbetet kurbet, edhe pse shkenca ka bërë mrekulli të paimagjinueshme me zbulimet e saja në kohën e sotme, për shkurtimin e distancave, transportin dhe komunikimin midis njerëzve me avionë supersonikë, prurjen e imazheve nga njera anë e botës në anën tjetër, me kompjuterat, internetin, skypen etj. Pra, edhe pse kurbeti i sotëm nuk mund të krahasohet me atë para një shekulli, kur niseshin për në Amerikë dhe Austarli gjyshrit tanë, kurbeti përsëri mbetet kurbet, i shkëput njerzit nga vendlindja, nga vatra familjare, nga shokët, miqtë dhe i përndan në vise të tjera, në vendeve dhe kontinente të ndryshme. “Guri rëndon në vendin e vet”, ka thënë mençuria popullore dhe këtë thënie s’ka gur që e luan.

Krahas shumë të këqijave kurbeti ka edhe ndonjë të mirë, do të thosha unë. Kjo e mirë lidhet me mallin, dashurinë, krenarinë dhe përkushtimin që lind në zemrat e mërgimtarëve që kanë zemër. Dhe janë pikërisht këto ndjenja që i bëjnë mërgimtarët që kanë talent e janë krijues, të ulen dhe të shkruajnë poezi dhe prozë për atdheun dhe vendlindjen që u mungon, për prindërit, vëllezërit, motrat, shokët, miqtë, për jetën e kaluar në vendet ku kanë lindur, janë rritur, edukuar e arsimuar dhe për jetën në mërgim, për vështirësitë që përballojnë e kalojnë.

Vetëm kur jeton larg tij e kupton se ç’është malli dhe dashuria për Atdheun tënd, për vatrën familjare, për familjarët e tu, për shokët dhe miqtë që të mungojnë.

Më ka rënë rasti të lexoj shumë krijime të mërgimtarëve. Krijimin e parë që kam lexuar dhe më ka habitur, ka qënë një poemë e shkruar në shqip, nga një bashkëfshatari im, i pashkollë, i quajtur Miti Gjilo dhe botuar në Amerikë në vitin 1910, me titullin: “Vojtjetore Amerika, sa e mirë Shqipëria”. Në atë poemë ai shkruan me hollësi për “cflitë”, siç shprehet ai, që heqin mërgimtarët që kur nisen për kurbet, për udhëtimin e gjatë me vapor dhe tërë kohën e tyre në emigrim.

Kam lexuar edhe shumë krijime të tjera për mërgimin, veçanërisht nga Naimi, Çajupi dhe Noli. Dhe ja tani së fundi më ra në dorë edhe ky libër, me titullin: “Mërgimtari”, i shkruar nga Lavdosh Isufi. Duke qënë libër me poezi dhe unë si një lëvrues dhe dashamirës i saj, e fillova leximin dhe e mbarova pa e lëshuar nga dora.

Përshtypja e parë që të krijohet kur mbaron leximin e këtij libri, është se padyshim ke në dorë një botim me vlera të spikatura ideore dhe artistike. Në të ka krijime shumë të bukura, shkruar me frymëzim e mjeshtëri të lartë nga autori, për atdheun, për historinë e tij të lavdishme, për luftrat e zhvilluara në shekuj për liri e pavarësi, ka krijime të arrira më sëmiri për familjarët, figurat e shquara atdhetarësh, poezi që rimojnë e kalojnë natyrshëm, me figura artistike të gjetura dhe të vendosura në vendin e tyre.

Ndër krijimet më të realizuara unë do të radhisja: “Mërgimtari”, “Malli për mëmëdhenë”, “Nënë mjo më ka marrë malli”, “Respekt për brezin tim”, “Pavarësia”, “Viti i mbrapësht”, “Vaçe Zela”, “Dritëro Agolli”, “Enver Hoxhës”, “Vlora”, “Nëna labe”, “I pa harruari”, “Nostalgji për Fierin” etj. poezitë për fshatin e lindjes dhe fshatrat e tjera të zonës, Gorisht e Sevaster, si dhe dy poemat: “Bota në vargje” dhe “Labëria”.

Në poezinë “Mergimtari” autori shpreh dhimbjen e thellë që mërgimi ka shkaktuar në zemrën e tij, ngaqë jeton dhe e ngys jetën larg atdheut të vet:

“Ku kam lerë dua të vdes,
 Toka ime le të më tresë,
 Do t’i shkoj varrit serbes.”
 Vendin tim s’e pres në besë!”

Dhe më poshtë në poezinëtë: “Nëna Shqipëri” dhe “Malli për mëmëdhenë” ai duke vënë në raport atdheun me mërgimin shkruan:

“Ti moj nëna Shqipëri,
 Mblidhi fëmijët në gji,
 I rrite me bukë e hi,
 T’u përndanë si me magji”...

“Shqipëri deti me valë,
 Mua fryma s’do më dalë,
 Po s’të pashë nuse mbi kalë,
 Porsi hëna përmbi malë”.

Këto poezi të Lavdoshit të kujtojnë vargjet e Çajupit: “Ku është balta,/ Me ëmbël se mjalta? / Po njeriu vetë,/ Ku kërkon të jetë?/ Në vendin e tij...”, pyet dhe përgjigjet Çajupi i malluar në mërgimimin e largët.

Si në këto pak vargje edhe në gjithë poezitë e tjera frymëzimi dhe dashuria rrjedhin si uji i kulluar i burimeve të Labërisë. Në to shkëlqen frymëzimi dhe talenti i autorit. Po këtë vlerësim do të bënim edhe për poezitë: “Fshati Sevaster”, “Për Gorishtin”, “Nostalgji për Fierin” etj.

“Majë e Hites për karshi,
 Shikon fshatin me zili,
 Tym i bardhë mbi çati,
 Në sofër mish e raki...
 “Që nga maja e Toganit,
 Dëgjohet cyla e çobanit,
 Bishtin tund qeni i stanit,
 Kur ndjen erën e tiganit”

Me shumë dashuri e nostalgji autori shkruan edhe për nënën labe në poezinë me këtë titull:

“Ç’të shkruaj për laben nënë,
 Është si dritë, është si hënë,
 Kam plot gjëra për të thënë,
 Sa dhe malet nuk i nxënë”.

Te poezia “Shqiptarë e Amerikës” autori ndjen zemërim e dhimbje për bashkëatdhetatë e tij të shpërndarë në 40 shoqata dhe shkruan:

“O Shqiptarë mos u përçani,
Se dhimbjet i ndjen vatani,
Si thotë bibela dhe kurani,
Rrini bashkë, mos u ndani.”

Ashtu si Pashko Vasha që thoshte: “**Feja e shqiptarit është Shqipëria...**”, Lavdoshi u drejtohet bashkëatdhetarëve në Amerikë me këto vargje:

“Shoqata jonë është Shqiptaria,
E ardhur nga Iliria,
Me origjinë nga Pellazgia,
E bekuar nga Perendia”.

Urrejtja për Europën plakë, që është sjellë si njerjë e keqe me Shqipërinë dhe në vitin 1913 e coptoi për të kënaqur oreksin e fqinjët e saj, e ka bërë autorin e këtij vëllimi të shkruajë poezinë “Europa”. Poezia është një satirë e mprehtë që demaskon gjithë pazarllëqet dhe intrigat e Europës ndaj Shqipërisë:

“Zakon të vjetër ka Europa,
Prish kështjella dhe hap gropa,
Gjuan me mitrolozë e topa,
Si nga termeti dridhet toka.”

Dhe më poshtë:

“Kush kish Shqipërin në dorë,
 Që e ndau si të ishte lakror,
 Në pesë shtete mbretërorë,
 Në çdo stinë acar e borë?!”

Po me këtë urrejtje ai shkruan edhe për pseudohistorianët e tipit Plasari, Butka, Biçoku e Meta, që për interesa të ngushta personale, pas viteve 90’, u vunë në shërbim të forcave regresive për të shtrembëruar historinë e lavdishme të LANÇ që:

“Historinë bënë politikë,
 Thonë se janë akademikë,
 Kanë ngrohur vezë në furrik,
 Se postet i zunë me mik”.

Me urrejtje ai shprehet edhe për figurat e errta, njerzit që shohin vetëm interesin e tyre, që përfitojnë pa të drejtë, të cilët i tipizon me gjëmbaçët dhe për satrapët e tradhëtarët si mbreti Zog, në poezitë: “Gjëmbaçët”, “Njerz të liq” dhe “Mretit Zogollian” :

“Gjëmbaçet shumë janë shtuar,
 Nga prezenca të shëmtuar,
 Thumbimin kanë të helmuar,
 Sa më shpejt do vaksinuar”...

“Dhe Ahamet Zogu i parë,
 Del i gjithi i pa larë,
 Si hajdut e tradhëtar,
 Me Sërbin bëri Pazar”...

Sa me indinjtë dhe urrejtje shkruan për Europën, pseudohistorianët, tradhëtarët, satrapët dhe “gjëmbaçët” aq me zell e dashuri shkruan poeti për Shqipërinë dhe qytetet e saj, e veçanërisht për Gjirokastrën, Fierin e Vlorën:

“Gjirokastër vend i nderit,
 Je vendelindja e Enverit,
 Ndrizon si dritë e fenerit,
 Lëshon ngjyrat e ylberit”.

Për Vlorën:

“O moj Vlorë legjendare,
 Je zhgabonjë dy krenare,
 Fluturon e s'ndalesh fare,
 Me ato vajza behare. “

Po me këtë frymëzim e dashuri autori ligjëron edhe për figurat e shqiptarëve që kanë bërë epokë, si Ali Pasha, Ismail Qemali dhe Enver Hoxha në poezitë: “Ali Pasha”, “Enver Hoxhës”, “I pa harruari” dhe të atyre që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë dhe jetën e Shqipërisë, siç janë poezitë: “Dritëro Agolli” e “Vaçe Zela”:

“Ti linde nga kënga,
 Me këngën u rrite,
 Si ylli i mëngjezit,
 Vendin seç e ndrite...”

Shkruan ai për Vaçe Zelën. Kurse për Dritëro Agollin:

“Dritëro të qofsha falë,
 Thuaju shqiptarve dy fjalë,
 Se shiponjat janë për malë,
 Zhabat janë për moçalë...”

Fjalët më të mira do të thoshim edhe për dy poemat që mbyllin vëllimin “Mërgimtari” të Lavdosh Isufit. Në poemën “Laberia” mbizotëron nostalgjia e poetit për krahinen e tij, për cilësitë e saj të rralla si trimëria, besnikëria, mikpritja, kënga tradicionale polifonike që me të drejtë është futur në thesarin e kultures botërore dhe mbrohet nga UNESCO. Dhe poeti shkruan:

“Laberi shkambi mbi mal,
 Çdo çoban një gjeneral,
 Nga ai shkëmb dhe unë kam dal’,
 Do te te vdese me ideal”.

Kurse në poemën “Bota në vargje” autori vë në dukje dhe qesëndis polarizimin e theksuar të shoqërisë në të pasur dhe në të varfër, luftrat e pa drejta e shkatërimtare që s’kanë të mbaruare, mbajtjen e njerëzimit nën presion, nëpërmjet terrorizmit të sajuar dhe propagandës së

shfrenuar, degjenerimin moralo - politik të shoqërisë nëpërmjet korrupsionit në qeverisjen e vendit, drejtimin e botës nga forcat e pa dukura të iluminatit dhe të bankierëve të mëdhenj, si Rrothçildët e Anglisë etj.

Janë këto tema që kanë trubulluar ndienjat e poetit në megrim dhe e kanë frymëzuar që të shkruaj një poemë për botën, nga fillimi deri në ditët e sotme. Prej saj kemi shkëputur tre strofa që na japin një opinion të qartë artistik të gjithë poemës:

“Kapitalizmit për merak,
 Mos t’i hamë të shkretin hak,
 Eshtë furnnaltë me oxhak,
 Kullon djersë e pikon gjak...
 Bota keq është mbarsur,
 Njëmijë veta të mbipasur,
 Shtatë miliardë buzë plasur,
 Përmbi gur kokën përplasur
 Bote e ndyre, bote e palar
 Ligjin bejn ca kusar
 Skan te ngopur as ne varr
 Han si krimba cdo lloj far”.

Poeti mergimtar mban mi supe kohen e gjate ne emigrim prej dy dekadash, dhe me eksperiencen e punes dhe te jetes ne dy sisteme dhe ne dy kontinente ka arrituj te bej nje analiz letrare fenomeneve te ndryshme te shoqeris ku ka

jetuar dhe ku jeton sote. Si nje njohes i mire I realitetit ka arritur te bej autopsine gjithë regjimeve dhe sistemeve politike duke filluar qe nga lashtesia. Kete e tregon me se miri fakti ku pershkrimin qe u ben luftave qe nga ajo me e vjetra, Lufta e Trojes, deri ne luftat e sotme qe nuk kan per te mbaruar kurre.

“Luftat behen per fitime
 Mafia shet armatime
 Tregu ben spekulime
 Bota mbushet me mashtrime”

Autori ka nje merit te vecante qe nepermjet nje filozofie popullorete nxjerre te verteten nga errersira mijevjecare qe mbulon historin e njerezis.

“Nuk ka rastesi ne kete bote
 Cdo gje e kurdisur me komplot
 Nga ata qe sundojn dije dhe sot
 Qe hambarit e tyre ti mbajn plot

 Ne cdo kohe keshtu ka ndodhur
 Pasuroheshin pa u lodhur
 Ta merrnin grurin te korrur
 Benin shkak nje miz te ngordhur

Përfundimisht e përshëndes dhe e përgëzoj autorin e këtij botimi dhe uroj që pena e tij të vazhdojë të na japi edhe në të ardhmen krijime të tilla të ndjera dhe të realizuara me mjeshtëri.

HYRJE

Ne pyllin e madh te poezis mbolla edhe une nje fidan te ri. Nga ana tjetere e Atlantikut dergoj kete peme si dhurate ne Atdheun tim. Nepermjet renjeve te kesaj peme magjike, pershendes vendim tim te shtrenjte, krahinen time te vendlindjes, brilanten laberi. Qytetin ku u rrita, ku kalova rinin time te bukur, ku dashurova me shpirt dhe me pasion, ku ndertova cerdhen time familjare.

Nepermjet trungut te kesaj peme, pershendes popullin tim te dashur, kete popull qe ka perjetuar ne shekuj mundime e sakrifica te shumta. Populli im qe dallon midis popujve te tjere si ylli polar ne hapesiren e pafund te yjeve. Populli im qe rezaton kulturen e tij te lashte, traditen e tij te vecante ne te jetuarit, te menduarit, te kenduarit ne gezime, te ligjerimit ne vaje dhe hidherime.

Popullit tim te mbrekullueshem qe zoteron instrumentin e beselidhjes, mbajtjen e beses se dhene dhe ate te mikpritjes se arte.

Nepermejt degeve te kesaj peme kujtoj edhe pershendes gjithë njerzit e mi te dashur, te familjes te farefisit, pershendes miqte edhe shoqerine time te dikurshme. Ata njerez qe ne vite kemi ndare hallet dhe gezimet me njeri tjetrin. Ata njerez qe kane lene mbresa ne jeten time, dhe sot me mungojn shume. Gjethet e pemes ja kam falur vjeshtes per te mbushur dysheket e dimrit pasardhes.

Feshferima e pyllit, cicerima e zogjeve, kenga e bilbilit, oshetima e maleve, gurgullima e ujrave, freskia e burimeve, dallget e detit, fladi i pranveres dhe debora e bardhe e dimrit jane si jete e gjalle qe kam pasqyruar ne keto poezi modeste.

Poezija ka patur dhe ka per nene dashurinedhe urejtjen. Dashuri per te bukuren , per te miren, per te arsyeshmen, dashuri per vete dashurine.

Dashuri per qiellin, per detin, per token, per njerzit, perguret dhe bimet, dashuri per femijen qe ka lindur ne kasolle, dashuri per gjyshin qe gedhende cibukun per kalorsit e lirise, dashuri per te rennet e lirise. Dashuri per vendlindjen dhe per Atdheun tend te shtrenjte.

Pjese e poezise eshte edhe urrejtja. Urejtia per te keqen, per te ligen, per te cinguaren, per shpirtligesine, urejtje per egoizmin dhe imoralitetin e semure te shoqerise. Urejtie per vete urejtien.

Ne cdo kohe dhe ne cdo system e mira dhe e keqia udhetojne bashke. Eshte I lumtur ai qe di te zgjedhi.

Problemimet e jetes jane te shume llojshme, te shtrira ne kohe dhe ne hapesire. Ne I perkasim atij brezi te mbarsur me vlera positive, me moral te larte shoqeror dhe familiar, ku e pergjithshemja eshte dashuria per njeriun, per punen, per cdo gje te mire qe krijuam me mundin dhe djersen tone. I perkasim atij brezi qe punoje shume dhe mor pake. Nepermjet poezive lirike te ngarkuara me atome positive te mbushura me oksigjen per jeten e gjalle te njeriut te sotem universal. Jame munduar qe ti shphre mendimet emija ne ate kende veshtrim qe une mendoje, duke u nisur nga eksperienca e jetes dhe punes ne dy sisteme dhe dy kontinete. Jemi ne mijvjecarin e trete te histories, ku kemi nje perplasje kulturash, nje perplasje qytetrimesh, nje perplasjesh sistemesh. Bota sa doli nga lufta e trete (lufta e ftohte) dhe ka nevojte per ngrohje, ka nevojte qe ti veshim asaje nje triko me duar te pastera, ka nevojte per nje mendje dhe drejtm te mire per te ardhemen. Shoqeria ne cdo kohe edhe sote ka nevojte per vepera qe ti rezistojne kohes. Jo fjale te bukura qe I mere era. Le te shpresojme.

Me sinqeritet nga vete autori.

MERGIMTARI

Ku kam lere dua te vdese
 Toka ime le te me trese
 Do ti shkoj varit serbese
 Vendin tim se pres ne bese

Ate vend qe e dua shume
 Nate e dite me le pa gjume
 Na mori vala per lume
 Permbe dallge do dal si shkume

Mergimtar ne vend te huaj
 Zemra ime e di sa vuaj
 Me lote kujtimet do shkruaj
 Si thesare do ti ruaj

Buken me djerse e fitoj
 12 ore ne dite punoj
 Koken larte sa te roj
 Shqiperin se turperoj

E kam ndergjegjen te lare
S jam hajdut e s jam kusare
Por mendoj si Atdhetare
Per shqiperin jam idhtare

Jam I lumtur jam krenare
Qe me zjen gjaku Shqiptare
Mendja ime zgjen karare
Per Shqiperin digjem ne zjare

Nuk bej pjese ne asnje shoqat
Nuk jam mesuar te bej shamat
I them fjalet me kamat
Ashtu si me thosh im at

Percjell vitet ne mergim
Mbushur zemra me trishtim
Qaj me lot per vendin tim
Kush na e solli kete hidherim

Rri dhe pres te telefoni
 Po dridhem si deg rigoni
 Jam ne gjume mos me zgjoni
 Po pres lajme nga gjitoni

Nena tu ket lene uraten
 Se keto pune keshtu e paten
 Plasi zemra cau shtrengaten
 Se arita dot te ngraten

Uji e balta nuk e treti
 E mban gjall amaneti
 Po prët djalin nga kurbeti
 Ka merak si shkoj shendeti

Nenat tona Trimeresha
 Neper male si Hyjnesha
 Neper fusha si Mbreteresha
 Te pa vdeksheme une i desha

Qaj Nenen qaj Babane
 Qaj Motren qaj Vellane
 Nga kjo bote ata u ndane
 Dhe kur iken ne su pame

Mergimtar kudo qe jeni
 Nene e Babe dot nuk gjeni
 Dhe Atdheun prane se keni
 Sa me shpejt mendjen ktheni

Se Shqiperia po na prête
 Hapur krahet per femijte e vete
 Vendin ton kemi kismete
 Let te vdesim me lezete

Nuk ka vlere leku kuletet
 Do ti shkojme te gjithë kenetet
 Kur te ndjejme plaget e jetes
 Ka mbaruar dhe lengu i qepes

SHQIPERIA IME (Poeme)

Atje large ne Ballkan
 Shqiperin time kam Vatan
 Plot me male ane e mban
 Bukurin te rrall e kan

Shqiperi o nena ime
 Kur me vine ato kujtime
 Qaje me lote e mallengjime
 Shohe ne ender rinin time

Shqiperi ilac I zemres
 Te kame ne vend te nenes
 Do ti thur vargjet e zemres
 Ti kendoje naten e henes

Shqiperi halle me derte
 Balta jote si mjalt blete
 Mua zemren sec ma trete
 Ma more te gjith per vete

Shqiperi o vende I rrall
 Bura e gra me yll ne ball
 Zjarin ndezin me sterall
 Ne cdo kohe per ty kam mall

Shqiperi ere trendafili
 Ne male kendonte bilbili
 Celte fusha nga terfili
 Sot ka dal mbi dhe kermilli

Shqiperi dallge e furtun
 Mbajte dyfekun nen gun
 Shkelqeve ne lufte e pun
 Nxore bura per tribun

Shqiperi ma plase zemren
 Nga goja ma hoqe kengen
 Do te qaj me lote si nenen
 Nga e hena gjer te te henen

Shtate dite e shtat net
 Per djemte qe u mbyn ne det
 Qe e lane ate vende te shkret
 Shkuan e vane ne kurbet

Shqiperi o nena ime
 Qaj me lot e ngasherime
 Me rite me ledhatime
 Do plakem me hidherime

Shqiperi cfar te ka gjetur
 Pse kaq shume me je tretur
 Si nena pa djal ke mbetur
 Fustanellen ta kan shqepur

Pse kaq shume halle te ran
 Kush ti dha mos gjent derman
 Pse keta njerz zemer katran
 Te kane kethyer ne nje han

Deputet dhe gjykates
 Vriten mu ne mes te pjaces
 Mafja ha brumin e palces
 Populli pi lengun e salces

Krimi dhe korupsioni
 Droga dhe prostitucioni
 Me te keqia se inkuzicioni
 Ne faqe te dheut sa her ti doni

Ne varreze nderkombetare
 E kethyet pa pyetur fare
 Sikur te ishte nje nen qyqare
 Pa djeme e pa vajza fare

Bujku nuk shkon me ne ar
 Grur e miser ska ne hambar
 Ne pylle levizin sa druvar
 Qe varre hapin me sqepar

Dhimbje ndjej ne kraheruar
 Pse keshtu keta njerz mizor
 Tallen me shqiperin e gjor
 Ka qene nuse me kuror

Ceshte keshtu;cfar ka ngjar
 Kokat presin si barbar
 A jane njerz apo panxhar
 Eshte ersir e ben acar

C'beni keshtu more te mjer
 Kujtohuni nga keni ler
 Mos u fusni ne cdo der
 Se u bete njerz pa vler

Pse keshtu Shqiperia ime
 Te kane bere cope e therime
 Ti ke qene nje zonje trime
 Botes I ke dhen mesime

Hajdutet me Kryeplakun
 Nate e dite ndezur cakmakun
 Me thika ta happen barkun
 Si vampire ta pine gjakun

Ruget mbushur plot lypsar
 Parlamenti plot kusar
 Kane nxjer nenen ne Pazar
 Sikur jane kollovar

Me femije te ngujuar
 Shume te rinje te droguar
 Me ministra te harbuar
 Bejne si qene te terbuar

A ka patur diell kjo bot?
 Me te mire se sa sot
 Nuk e dim cdo ket mot
 Te presim te mos qajme melot

O ti popull Shqipetar
 Historia te ka par
 Te ka shkruajtur legjendar
 Ne cdo kohe ke dale I par

Jame Shqipetar e bir shqiptari
 Nga steralli ka dal zjari
 Gjaku I kuq nga Damari
 Do betohem si ushtari

Atje ku eshte car ugari
 Ku ka derdhur djers fshatari
 Do ve koken te hanxhari
 Do mbroj nenen nga kusari

Nena ime eshte shqiperia
 Do ti fale ditet e mija
 Te mos zbres nga zonjerija
 Ti ndrije balli nga bukurija

Shqiperi toke e pergjakur
 Neper shekuj e perflakur
 Neper dallge e sperkatur
 Si anije ne dete te hapur

Shqiperi halle me derte
 Ke kaluar shum trmete
 Ne stuhi ne male e dete
 Je semurur po su trete

Shqiperi o yll I ndritur
 Do vije dita qe ke pritur
 Gjer athere djemte jan ritur
 Neper vite jane gatitur

Ti moj nena Shqiperi
 Mblidhi femijet ne gji
 I rrite me buke me hi
 Tu shperndan si me magji

I gjithë vendi vetetin
 Reflekton gjith bukurin
 Do flas vete me perindin
 Qe ti fali perjetesin

Nga Qielli te zbres perendija
 Nuk gjene dote si Shqiperia
 Me e bukur nga gjithesia
 Eshte e kuqe nga trimeria

Shohe ne enderShqiperin
 Nga Vermoshi ne Delvin
 Mbi male bora po shkrin
 Neper fusha vesa po nderin

Nuke ka si Shqiperia
Qendisur ne syte e mija
Kur te vdes nga pleqeria
Da le trashgim te femija

Shqiperi vendi I bekuar
Rri gjithmon duke menduar
Nate e dite me mban zgjuar
Qofshe perhere e nderuar

Shqiperi fole shqiponje
Trualli jote lule begonje
Ne dite zije ti kendoje
Te keqen ti paralajmeroje

Historin ke te trishtuar
Me shume ke qen e pushtuar
Po as nje here e gjunjzuar
Gjithmon vlera ke treguar

Une per ty Shqiperia ime
Do kendoje me ligjerime
Se nga ty mora mesime
Ndaj te fale dhe jeten time

Jame I lumtur dhe krenar
 Qe kame emerin Shqipetar
 Do digjem ne flake e zjar
 Sa te dal gjak mbi damar

Shqiperi o gur steralli
 Vec per ty me ka mar malli
 Me dhemb koka me djeg balli
 Ne megrim me coje halli

Po nuk gjeta dot sherim
 Le te vdes ne megrim
 Amanet da le me shkrim
 Te me cojne ne vendin tim

Shqiperi moj gryke zen
 Me ke djale e te kam nen
 Do ta mbaj fjalen e dhen
 Do te gjej ku te kam len

Le te jeme ne mes te hallit
 Une per ty si ndahem mallit
 Do te qendis ne mes te ballit
 Qe ta marre pertej varrit

Shqiperi o ylle e drit
 Leshon reze ne Orbit
 I ke te gjitha miresit
 Na rite nderin per cdo dit

Natyra ty te ka nderuar
 Male fusha te gjelberuar
 Dhe lumenje te kulluar
 Me nentoke te pasuruar

Shqiperi kushtrim lirije
 Here ne drite e her ne hije
 Ke nxjer koka babezije
 Si dhe trima diturije

Historija I ka ndar
 Kush I lik , kush tradhetar
 Patriot dhe dijetar
 Kan ndricuar si fanar

Shqiperia e Pellasgjaneve
 Trashgimtare e Ilirianve
 Shqiperi trualli te pareve
 Si shqiponja ne maje te maleve

Shqiperia e Skenderbeut
 Me I madhi burri I dheut
 Mori shpaten e Promotehut
 Largoj Turqit prej memedheut

Shqiperi q Enver Hoxhes
 Qe I dha mesime Botes
 Si ta ruajm hyrjen e portes
 Te mos hyje miza poshte rrotes

Te mos hyje as kali iTrojes
 Qe u be shkaku I pasojes
 Qe iku Troja prej gezhojes
 Humbi rugen e pervojes

As nje here nuk u gjunjezove
 Gakun tende ti pervelove
 Trimat per liri dhurove
 Larte ne qiell emrin e shkrove

I dhe mbreter Perandoris
 Ne Kohen e larget te Iliris
 U rrite shkalla e xhelozis
 Nga gjith shtetet e fqinjesis

Te thuri vargje Bajroni
Shqiperi kala betony
Shpalose flamur nejloni
Nuk u trembe nga cikloni

Matuni mire kur te shkoni
Ju presin si e do zakoni
Po s'ju japin cfar kerkoni
Me ta besen ta bashkoni

Sipas vete Edit Durhanit
Shqiperi brengje e Ballkanit
Dalin trimat prej istikamit
Nate e dite roje vatanit

Shqiperi o gure diamanti
Me rrehe zemra si sehati
Ne cdo kohe do te jem gati
Do te mbroj ty nga lugati

Se lugetrit shume jane shtuar
Me politiken e amshuar
Te duan tyja te coptuar
Veten e tyre te pasuruar

Politikan dhe qeveritar
Qe te gjith jane kusar
Race e poshter e pa par
Shqiperin kan percar

Shqiperi nene e Naimit
Qe na dha netet e zgjimit
Nuk I duam ditet e varrimit
Po duam gjakun e kushtrimit

Shqiperia e Vegjelis
Ne balle Yllin e liris
Perkrenare e liris
Je lavdija e trimeris

Shqiperi o nena ime
Me rrite me shum mundime
Ke zen vend ne zemren time
Nuk I haroj ato kujtime

Kush ma fali Shqiperin mua
Qe kaq shume ate e dua
Babaji ime mu betua
Ruje djal si syte e tua

Amanetin qe me dha babaj
 Une per jete do ta mbaj
 Me lote guret do ti qaj
 Ne zemer emerin e saj

Do I le dijalit amanet
 Qe ta doj si nenen e vet
 Mua varri sdo me tret
 Po nuk gezoj Shqiperia jet

Shqiperi ylli me zjar
 Neper shekuj e mijevjecar
 Ke ndricuar si margaritar
 Na dhe emerin Shqipetar

Emerin qe e mbajme me nder
 Nga femija I po sa ler
 Gjer te vdekja me shum vler
 Kur jep jeten per te tjer

Do shkruaj vargje pa mbarim
 Qe te qetsoji shpirtin tim
 Qe po vuaj ne megrim
 Shikoji endera pa pushim

Brez mbas brezi shqiperia ime
 Kenge vaj me ligjerime
 Do kendoj per ty o trime
 Une per ty do fal dhe jeten time

Shqiperi deti me val
 Mua fryma sdo me dal
 Po ste pash nuse mbi kal
 Hene te plot permbi mal

Shqiperi halle me derte\
 Zemren time ti ma trete
 Harten tende da mare me vete
 Atje poshte kur te vete

Shkruajta deshirat e mija
 Te rroje ne shekuj Shqiperia
 Le te lulezoje lumturija
 Jete te gjate gjith njerzija

NENE MOJ ME KA MARRE MALLI

Buze liqenit Micigan
Dale e kujtoj dynjan
Kujtoj qytetin kujtoj fshan
Kujtoj me mall vatan

Kujtoj nenen dhe babane
Per te dy zemra me qane
Se kur iken e na lane
Jete te gjat ne na thane

Une po shkruaj per nenen time
Plot me mbresa dhe kujtime
Ma ka mbushur zemren time
Ndaj dhe kam detyrime

Nuk po shkruaj per vajzerine
As per lule nuserine
Se vet e kan bukurine
Si livadhi me trendeline

Vec ninullen kur kendove
Bilbilat ne bace i mblodhe
Nene u bere dhe gezove
Jeten bukur ce fillove

Por shpejte hallet ty te rane
Filloi lufta ane e mbane
Kunatin qave dhe vellane
Qe rane deshmore per vatane

Me parmend aren lerove
Drute nga pylli ne shpine i solle
Me qumesht dhije buzet freskove
Dhe nga lodhja veten se leshove

Shamin lidhur mbi balle
Permbe supe hedhur shalle
Kur kaloje ne mehalle
Si zhgabonja ne peralle

Nene moj me ka marr malli
 Me dhemb zemra me djege xhani
 Se jam large nga vatani
 Zjarin s'ma shuan dot oqeani

Doren tende ndjej mbi balle
 E kujtoj e me merr malle
 Si lumi qe shkon mbi zalle
 Nuk te harroj sa te jem gjalle

Fotografin kam varrur ne murr
 Ne fytyre te ndrine nje nure
 Si feneri lart mbi ure
 Leshon drite qe nuk vdese kure

Ke gene nene e zonjerise
 Dhe simbol i urtesise
 Kiske zemren e miresise
 O fisnike e laberise

Obelisk do ngre per ty o nene
 Hapesiren te pershkoj gjer ne hene
 Mbi re gjithmon te qendroshe
 E boten nga lart ta shikoshe

MALLI PER MEMEDHEN

Kam malle per Memedhene

Se atje kam lene folene

Me te mire ilac nuk gjene

Nuk roj dot pa oksigjene

Jam semur me migrene

Nuk e di nga se me vjene

As doktori dot se gjene

Thon eshte mall per memedhene

Pse e pata une kete fate

Do te ngele si lis i thate

Larg Atdheut ne mergate

Punoj dite e punoj nate

Ku e lash varin e Nenes

Me djeg zjarri brenda zemres

Ku e lashe Shqiperin e kenges

Atje large mes e Legjendes

Mergimi shoke Mergimi

Digjet zemera nga hidherimi

Dalin lote nga mallngjimi

Pse te vuaj kaq shum njerzimi

Po u la ky lloje terbimi
Do vine dite asimilimi
Sa me pare do dhen kushtrimi
Te kthehemi te Bashkimi

Ne nga halli u shperndame
Se nuk kishim buk te hame
Berisha nxori fermane
O me ne o ler vatane

Ikem dhe Shqiperin e lame
Neper bote u percame
Mbrapa henes shkuam e vame
Per nje ender qe ne pame

Terapia ne kazane
Ceku bardh ne filxhane
Matrapazet zgjejn dermane
Shqiperin duan ta hane

I vune zjarrin ane e mbane
Pike meshire ata skane
Popullin ne balte e lane
Per vete moren sermane

Kujtoj shoket e Idealit
 Per te gjith si ndahem mallit
 I larguar vec prej hallit
 Amanetet do tja le dialit

Me merr malli per Shqiperine
 Per simbol ka bukurine
 Malet ne balle ci rrine
 Fushat ne faqe i ndrine

Korabi me gjith Shkelzene
 Si mburoj ne qiell i gjene
 Nga Serbia mbrojn Atdhene
 Derdhin lote per Migjene

Moj lugina e Valbones
 Melodi i jep jehones
 Meri krahet e shqiponjes
 Shpernda lulet e begonjes

O Tomor o mal i larte
 Porsi kulla me sahate
 Qe mat kohen dit e nate
 Leshon reze mbi Berate

Ty natyra te ka stolise
Me germa ari te ka qendise
Ti tregosh historise
Per te madhin e Shqiperise

Drini, Vjosa dhe Shkumbini
Uji kristal si nga burimi
Nje urim prej njerzimi
Ne keto troje perjet te rini

Kur del dielli ne mengjese
O ju fushat e myzeqese
Si pasqyre e lar me vese
Zemra ime ri me shprese

Sazani ne mes te detit
Me i bukuri Vilajetit
Vijn gomonet e kurbetit
Zbrasin arkat e kismetit

Ti moj qafe e Llogarase
Ma mbush zemren me marase
Embel kujtimet vijne pase
Kujtoj vitet e sevdase

Pishat e larta hije leshojne
 Dhe njerzit nen to pushojne
 Per nje cast hallet harojne
 Me nostalgji te shkuaren kujtojne

 Djelli lind shpejt e von perendone
 Ujte e ftohte me shkum gurgullone
 Rrugen me drethka per ne det vazhdone
 E di vet nga vjen e nga shkone

 Me Potam e me Spile
 Moj Himar e bukur lule
 Nen qiell e permbe dhe
 Je si perle ne mesdhe

 Mali i Gribes ne Laberi
 Lar kurora me flori
 Ka te shkruar nje histori
 Kurveleshin per trimeri

 Kush mendoj per Memedheun
 Te par kemi Skenderbeun
 Per te dyte Ismail Beun
 Mbi te gjith Prometeun

Ai i qe I kundershtoi perendise
Se i dha zjarin njerezise
Drite i dha verberise
I dha dije vegjelise

Naimi me gjith Samine
Abdyli me Kostandine
U fjalosen me Turqine
Per ca shkronja per Shqiperine

Fanoli me gjith Migjene
Mbretit Zog kembet ja prene
Ja vune koken ne legene
Gjersa iku e mori dhene

Bur i shquar e Politikane
Poet i math me shpirt humane
Me i ndituri sot ne vatane
Zeri i degjohet ne cdo ane

Dritero mos ki siklete
Vjersha jote ne gazete
E ka thene fjalen e vete
Kush eshte bur me te vertete

Koken larte mos mbaj merine
Se ke djemt per pleqerine
Japin jeten per lavdine
Dite me te bukura do vijne

Se ne do vime nje dite
Te gjith bashke si Petrite
Naten do ta bejme drite
Shqipja jone te llamburite

Shume ke patur Timonier
Mbi te gjith ke pas Enver
Qe pershkoi stuhin me er
Pa u trembur asnjeher

Ke patur dhe shume tradhetare
Qe te futen te gjall ne vare
Ata sjan as pak shqipetare
Po bastard dhe zuzare

Kam mall per vendin time
Per cdo dit ne agime
Nxjer nga zemra nje urime
Ne per shekuj me begatine

KOSOVA

Historin me gjake e shkrove
Derdhe lot sa i shterove
Zemren zjarre e povelove
Trimat ne Parajse i cove

Padrejtisine shekullore
Nga nentoka vete e nxorre
Kuroren me lule bore
Bashke me flamure i more

Ne cdo vend ku ndeze zjarre
Shkelqeve si Kosovare
Trim o trim Adem Jashare
Si dragua legjendare

100 vjet nen Serbine
Gjakun derdhe per lirate
Dhe fitove pavarsine
U bere me demokracine

Bashkohu dhe me Shqiperine
Te krijoni Memedhesine
Bota tua kete ziline
Per te bukur mencurine

O ju popull Kosavare
Coni lule permbe vare
Per gjithe njerzit qe jane vrare
Historia hake do marre

CAMERIA

Po shkruaj me dhimbje shpirterore
Per nje tragjedi te rende njerzore
Zbatuar me forma me mizore
Te shpikura nga mendje djallzore

Nate e zeze me plote horrore
Ne Cameri beri terrore
Ngulen thiken ne kraharore
Kokat prene ne obore

Kriminel dhe mercenare
U versulen si barbare
Dolen naten si kusare
Genocid i pa pare

U sulen si ujku i kermes
Cane me thonj barkun e nenes
Femijet hodhen ne driten e henes
Sikur ishin kopsa e menges

Gra e Pleqe u masakruan
 Me violence u dhunuan
 Nga Cameria i larguan
 Kethim mbrapa nuk lejuan

Krahu tjeter i Shqiponjes
 I priti si djemte e zonjes
 Dolen si plumbe para gezhojes
 Ndane me ta kafshiten e gojes

Plage e vjeter e zbuluar
 Edhe sote nuk eshte sheruar
 Politika eshte korruptuar
 Turpi I Botes se qyteteruar

Cameri dhe Laberi
 Motra jeni ne Toskeri
 Jeni bija ne Shqiperi
 Mbesa jeni ni Iliri

Do vi dita dhe nje here
 Do cele lulja ne pranvere
 Do kalosh mbi Ylbere
 Do te zgjohesh ku ke lere

EUROPA

Zakon te vjeter ka Europa
Prish keshtjella dhe hap gropa
Gjuan me mitroloza topa
Si termet dridhet toka

A moj Evropa plake
Duart ci ke lare me gjake
Nga goja helm e farmake
Pa drejtesi ne cdo bajrake

Fashizem e Nazizem polle
Gjith boten percellove
Ducen e Hitler besove
Veten kurre se gjykove

Kush e kish Shqiperine ne dore
Qe e ndau si te ishe lakrore
Ne pese shtete mbreterore
Ne cdo stine leshuan debore

Ish Bismarku ne Berline
Bashk me Carin ne Kremlin
Dhe Mbreteresha me Angline
Qe e coptuan Shqiperine

E verteta te tregohet
Historia nuk harohet
Vete Europa te pendohet
Se Shqiptari nuk gjunjehet

Ligjin e luftes mban Greqia
Ben sehir demokracia
Sepse vuan nga hipokrazia
Eshte semur nga xhelozia

Ne gjume i del Vasiliqia
E shoqa e Aliut nga Shqiperia
Ne gjunje i ulesh gjith Greqia
Vezirit te madh nga Laberia

Hebrejte shtetin kan blere me flori
Ne ora 6 postblloku ulet ne ZYRIH
Cifutet flen te qete mbrohen me polici
Popujt sqenkan njesoj spaska barazi

Ku ishe ti plaka Europe
 Te gjall e te vdekur ne grope
 I perdore si mish per tope
 Sikur te ishin vic e lope

Tym e flake ne Kroaci
 Lufte e madhe ne Slloveni
 Ne Kosove e Cameri
 Te drejtat shkelen per cdo njeri

Diten per Elsinkin betohesh
 Naten me jorganin e krimet mbulolesh
 Diten mekatet fal ne kishë
 Naten gelltit kufoma si bishe

Vec kralet e Serbise
 Jan simbol i mizorise
 Sllobodan i Tiranise
 Karaxhic i shpirtligesise

Moj Europe me zjare ne dore
 Polle mbreter dhe diktatore
 Qe mbi koke te vune kurore
 Me intriga neper oborre

Perandore dhe legjendare
Napolon dhe Jul Cesare
Te vun flak e te vun zjarre
Por ti zgjete kur karare

Eleni Fisher e Doris Pake
Jane shushunja qe pin gjake
Ne Shqiperi nderhyn pa shkake
Mbeshtesin ca alabake

Padrejtesin dot sduroje
Te kem force e ta ushtroje
Nga faqe e dheut ti qeroje
Cilin do qe do spekulloje

Boten dua njesoj te jete
E globi nje ngjyre te kete
Pranver stinet le te jene
Zogjte mos ndryshojn folene

RESPEKT PER BREZIN TIM

Kam respekt per Brezin time
Se punoj me perkushtime
Per cdo dite ne agime
Me komande bente zgjime

Punuam pa u lodhur fare
Mbushem kodrat me brezare
Benim pune vullnetare
Prisnim fera e kocimare

Nga mulliri ne kanale
Ndertuam diga hidocentrale
Antena ngjitem ne male
Me boten lidhen sinjale

Ne cdo fshat cuam uje dhe drite
E kthyem naten ne dite
Ne muze i cuam qirinjte
Per te ruajtur vume arinjte

Mbushem fushat me pallate
Me uzina e kombine
Me hotele 15 kate
Ne lume djersa c'na vate

Mbyllem kisha dhe xhamia
Me deshire nga vet Rinia
Pa vendim nga Qeveria
Besim kishim te drejtesia

Mos gjykoni per se thati
Prisni sa tu dal inati
Kur te vije ora dhe sahati
Do ta keni cdo gje gati

Historia le te shkruaje
Te verteten te zbuloje
Inventar i shkruar me boje
Qe te luga e piroje

Ndertuam spitale dhe shkolla
Ku sherbehesh pa te holla
Me femije te kuq si molla
Neper trup nuk kishin njolla

Ne ndertuam nje bote te re
Me oxhaqe gjer ne re
Qe u kthyen ne minare
Sipas modes me te re

Me ushtri dhe me marine
Neve mbrojtem Pavarsine
Nuk e shitem Shqiperine
Si Ilir Meta me Saline

Ne kenduam dhe hodhem valle
Neper fusha neper male
Morem pjese ne festivale
Se nuk kishim kaq shum halle

Tham mocale dhe keneta
 Punuam si punonte bleta
 Dem na vajten djerset e shkreta
 Se na mbeti bosh kuleta

Neve mbetem fukara
 Bankat mbushen me para
 Se menduam per pasterma
 Per te keqen qe na ra

Se ku vane parat e shkreta
 Me vone do dale e verteta
 Sal Berisha e Ilir Meta
 I shperndan ne dy tre veta

Me zagar qe nderojn stane
 Dhe lepin cdo sahanë
 Era qelben gjithë dynjane
 Pllaken dredhin si rufiane

Ne nuk ishim as mushke as kuaj
 Si thone ca te shitur tek te huaj
 Komenton dhe Prenc¹ Fajkoj
 Sipas stineve pendet me boje

Se ne ishim njerez me vlere
Na vlersuan dhe ca te tjere
Su turperuam asnjehere
Shqiperine beme me ndere

Jeniceret e Anadollit
Duall nga shpella e Vicidolit
Se ci vun flaken truallit
Po si kulles se Babilonit

I gjithë vendi mori flake
Vet Neroni krijoi shkake
Per te shkuaren kish merake
Kish ngrene buke ne uturake

Ngrehuni ju trima nga varri
Se Shqiperise ju vu zjari
Vet Berisha strumbullari
Gazi Dede mercenari

Ky Neroni i Demokracise
Dem i beri gjith Shqiperise
Deboj ajken e shoqerise
Qe ky vet te livadhise

Mbylli shpresat e Rinise
Moren rruget e arratise
Gjith vendi u braktise
Pllakosi dita e zise

Kur te vij dita ai te vdese
Per mbi varr do ti dhjese
Eshtrat do tia fuse ne these
Per fosile do ti shese

Pike nishani te mos i mbese
Se ishe burre i pa bese
Shqiperine e ndau ne mese
Se ashtu kish interese

Brezi im lavdi plote
Na vate mundimi kote
U shperndam neper bote
Per Shqiperin vetem lote

Do vijne dite me te ngrohta
Ti harojme keto te ftohta
Se kjo bote eshte me rrota
Shkon ne male dhe zbret ne gropa

PAVARSIA

Ne gjerdanin e Historise
Shkelqen dita e Pavarsise
Nata e bardhe e Lirise
U shkeput prej Roberise

Me njezet e tete Nendore
Ne kete muaj shekullore
Shqiperise ju vu kurore
U ngrit Flamuri ne Vlore

Amanetin e Skenderbeut
E nxuaren dallget e Mesdheut
Qe ti vere emer Atdheut
Shqiperi e bukur e dheut

Do kujtojme ne pervjetore
Gjithe ata qe rane deshmore
Per Shqiperine u bene therore
Permbi koke tu veme kurore

Te pare kemi Ismail Qemale
Qe punoje per Ideale
Nuk ish plak po ishte diale
E kish zemren sa nje male

Rilindasit leshuan shkendite
Shume u lodhen per kete dite
Nga erresira ndezen qirite
Shqiperise ti japin drite

Ne keto vite te Pavarsise
Pune I prishen Shqiperise
I hodhen Vellon e zise
Ca pinjolle te poshtersise

Ata shiten Shqiperine
Ahmet Zogun me Saline
Njeri veriun per Serbine
Tjeteri jugun por Greqine

Kush mbrojti Pavarsine
 Enver Hoxha me vegjeline
 U ndeshen me Perandorine
 Nga Vlora debuan Rusine

Shqiperi vendi Shqiponjes
 Neper grykat e Jehones
 Mbi supe vellon e Zonjes
 Qendise Yllin e Zhgabonjes

E kish vene Skenderbeu
 E vulosi Ismail Beu
 E ngjyrosi Prometeu
 Si e deshi vete Atdheu

Ti nuk je njeqindvjecare
Shume selvi mbollet ne are
 Leshuan dege celen lastare
 U shumuan e u shperndane
 Moren boten anembane

Laben nene se harojne
Nate e dite per te mendojne
Jete te gjat i urojne
Me radh shekujt numerojne

O moj nene e Laberis
Tunde djepin nen lis
Rrite brezat e liris
Qellin me yje qendis

Me drugen e leshit
Toret historine
Ne zemrat tona
Mbollet krenarine

Brezat qe vine pas
Do tua dine miresine
Anembane Atdheut
Do ta ngrene dollin

MALET E VASHES

Te malet e vashes, legjenden degjova
 Per vajzen e bukur, historin mesova
 Per shekujt qe shkuan, vargjet i shkrova
 Per brezat qe vijne, dashurin ndricova

Na ishte nje vash, me emrin Sabrina
 E bukur si lule rritur ne lendina
 Kur dilte nga shpija ndriconte Vllahina
 Kur shkonte ne rruga zbardhonte krahina

Kur shkonte me shqera, dy djem dashuronte
 Kur binte te flinte, nje ender shikonte
 Kur celte agimi, zemra vezullonte
 Kur vinte erresira, qerpiket lotonte

Ne halle kish rene, te dy djemt I donte
 Per secilin djale, kenge do kendonte
 Sa me shume mendoresh, koha po kalonte
 Po afronte dimri, koha po gjemonte

Djemt u vune ne garre, kush ta doje me shume
I percolli fshati, tek zalli mbi lume
Si dhendur u nisen, veshur me kostume
Zemrat I gufuan, si dallge me shkume

Per te shkuar te vasha, malin e vrapuan
Kur mbriten ne maje, zemrat I pushuan
Kur degjuan bilbilat, kengen e ndaluan
Qe nga maje e malit, guret u rezuan

Fryne nje ere nga Vllahina
Hapi kujen vete Sabrina
Perhap lajmin Gjeraqina
Nga Sazani tek Kanina

Qielli ndrine nga vetetima
Larte nga malet vjen oshtima
Zojte u tremben nga ulerima
Qajne thellenzat ne bokerima

Mbi oxhakun e shtepise, korbi izi kendoje
Do te ndodh nje kuje, fshatin lajmeroje
Fjalet qe tha korbi, vajza si besojte
Nga fundi I oborit , me gurte e qelloje

Kaluan vite shume behare
Qante vajza ne dy vare
E kaloj jeten qyqare
U betua su martua fare

NATYRA

Natyra ka te panjohura, njerezit akoma nuk i dine
 Me radhe stinet ndrohen dhe njera tjetra se arine
 Shkenca per dite e me shume sberthen gjithesine
 Por stinet flasin vet qe secila ka me vete bukurine

Me e bukura nga te tera stinet eshte pranvera
 Vjen pas dimrit qe ikin i semur nga kolera
 Ne pullazet e shtepise ndallandyshtet ngren folera
 Femijte shkojne ne shkollë me rroba te porsa blera

Dallandyshtet lajmerojne se erdhi pranvera
 Manushaqet celin te parat si nga hera
 Livadhet mbushur plot me lule shqera
 Qengjat kullosin ne gemusha e fera

Me radhe lulet po celin i bukur trandafili
 Zogjte nga larg po vine, po kendon bilbili
 Ne qiell yjet po ndrijne si flake kandili
 Xixellonjat vallen perdredhin tek fitili

Pranvera eshte magjike, te verbon bukuria
 Celin bajamet, shega, ftoi dhe qershia
 Plot me arome te mbushet mushkria
 Te gufon zemra dhe jet mer dashuria

Pranvera dhe vera, vendin me lule qendisin
 Si dy motra te bukura te gjith i duan e i begenisin
 Punet e stines se tyre dine vet ti nasqerisin
 Pemet me kokra, arat me te mbjella vet i stolisin

Vera e bukur vjen e na gezone
 Kori i gjinkallave ne pyje po kendone
 Larte ne qielli dielli po qendrone
 Cdo gje ne tok me rezet e tij bekone

Vera eshte e begate, hambaret mbush me bereqet
 Njerzit te lumtur shkojne secili ne punen e vet
 Per dimrin qe vjen pas bejne gati te gjitha zairet
 Te gezuar urojn njeri tjetrin plote jete dhe shendet

Dielli eshte i nxehte te djeg e te pervelone
 Ne mes te dites, drita e forte syte te verbone
 Leviz me ngadale e duket si ne vend qendrone
 Te nesermen del prap kur dita e re po agone

Cobani ne male ujin e ftohte bekone
 Mes pyjesh dhe malesh jeten gjallerone
 Udhëtarin e panjohur per mik e ftone
 Simbas zakonit me mish te pjekur e nderone

Ja dhe vjeshta zhurem ben nga do qe shkone
 Fryn si e cmendur, gjethet e pemes ne tok rrezone
 Dritaret perplas, tjegullat levis, catin zbulone
 Per ardhjen e dimrit, zogjte per shtegtim lajmerone

Ne vjeshte bihen shirat e shumta dhe permbysin dynjane
 Perenj t fryhen nga uji dhe fushat mbulojne ane e mbane
 Nga malet uji zbret me furi dhe cgjen perpara e perlane
 Njerzit levizin me shpejtsi dhe gjes se gjall i bejn dermane

Vjeshta motra e madhe anen e te vllait mbane
Me gjethe mbush dyshekun boren perdor si jorgane
Triko e corape thur, bastunin ja ben gati se ja di sevdane
Per dy motrat e tjera mbrapsht flasin, xhelozu kane

Dimri eshte arrogant, pushtetin me dhune e mbane
Shi dhe breshër, debore dhe stuhi leshon per fukarane
Per te pasurit se ze gjumi, mendon ctu jap te hane
Dhe ata nuk kursehen, han e pijnë si kuajt ne hane

Debora bije ne male, si vello e bukur zbardhon
Ne gryka e livadhe, ne kodra e fusha qetesia mbreteron
Mes mjegullash nata po afron e dita po perendon
Ikin ditet, javet e muajt, si ne parad viti i kalon

Hena leviz ne qiell dale nga dale
Dallget e detit shtyhen tutje vale vale
Era fryn si e cmendur male me male
Dimri largohet koke ulur cale cale

Keshtu ndodhe me cdo stine
Ne miljona vjete e njejta rutine
Sipas radhes nje nga nje ikin e vine
Natyra me ligjet e saja mbajne regull sine

Qajne kur vine se e dine qe do ikin
Qeshin kur ikin se e dine qe do vine
Njerzit mundohen te panjohuren te dine
Me telescope vrotojn perher yllsine

BOTA NE VARGJE
poeme

Sipas shkences e verteta
Miljona vjete na qenka jeta
Plot mistere te mfisheta
Kohet e para kane qane te shkreta

Jeta e pare doli ujore
E dyta na ishte bimore
Jeta e trete ishte shtazore
Vjen e katerta njerezore

Miliona vite te shkuar
Historia vet ka shkruar
Neper shekuj eshte cikluar
Por te tere se kan besuar

Sipas tezes te Darvinit
Gjith procesi i zhvillimit
Ne gjith boten e njerzimit
Eshte krijuar prej evolimit

Permbi Afriken veriore
 Doli race e pare njerzore
 Me pak dije ndergjegjesore
 Dhe zhvilluan jeten tokesore

 Ne tre epoka u be zhvillimi
 Sa u persose civilizimi
 Dhe arriem tek qyteterimi
 Pune te madhe ka berre njerzimi

 Neoliti eshte epoka e pare
 Njerzit mesuan te ndezin zjarre
 Jetonin ne kope te pa ndare
 Rrinin dimer e behar te pa lare

 Neolitika¹ ishte shume e gjate
 Natyra krijonte perhere disfate
 Sistemi ishte Matriakate
 Komandimin e benin grate

 Epoka e Bronxit eshte e dyta
 Ndahet gruri nga gezhyta
 Luftohet me shpata e qyta
 Nuk kish dale pushka me tyta

Epoka e Hekurit eshte e treta
Shkenca beri punet e veta
Zbuloi shume te verteta
Po ka akoma plot te meta

-- II --

Per efekt te historise
Po them racat e njerezise
Qe nga lindja e Japonise
Ne perendim te Kalifornise

Rraca e bardhe eshte Ariane
Rraca e zeze eshte Afrikane
Rrace e verdhe Mongoliane
Jane produkt klimateriane

Bota u krijua nga barazia
Me vone lindi e u perhap babzia
Miljona njerez vdesin nga uria
Te pasurit fryhen nga mushkria

Ne fillim ishin te gjith komunare
Me von u beme skllavo pronare
Sklllevrit germonin cdo dite ugare
Pronaret mbuloheshin me are

Pronaret u kthyen ne feudale
E shtuan pasurine e ben sa nje male
Bujkrobrit mbeten rrenjdale
Punonin me meditje cdo dite si kale

Kapitalizmi per merake
Mos tia ham te shkretin hake
Eshte furnalte me oxhake
Kullon djerse e pikon gjake

Ne fabrikat e metalit
Ndihet forca e kapitalit
Mbushen thaset e dollarit
Vetetin balli i pronarit

Ja dhe boset e dollarit
Me flori patkonjte e kalit
Si shushunjat e mocalit
Po pin gjakun e proletarit

Keta te pasur barke gjere
Boten duan ta ken te tere
Kur skane qepur me gjelpere
Pune te liga plote kane bere

Si Morgani e Rok Felere
Ka patur e shume te tjere
Qe kan vdekur si kan lere
Krimbi i hengri si pa vlere

Si Maducet e Italise
Dhe Rothcildet e Anglise
Shtuan hambaret e pasurise
Duke pire gjakun e njerezise

Kush ka bere me shume dollar
Boten ka nxjer ne Pazar
S'ka problem ne eshte truthar
Gradat I mere pa kandar

Shume u shtuan keta boset e dollarit
Dualen si krimbat e mocalit
U ngjiten perpjete malit
Tunden shkunden si bisht I kalit

Per drejtesi kane gryken e pushkes

Kane moral florin e gushes

Kullosin te hani I mushkes

Hane e pine si babi mushkes

Plote me banga ne cdo shtete

Zbatojn ligjin per fajdete

Te japin dy te marin njezete

Dhe ta lene kuletën shkrete

Kredi kartat si tollona

I perlajne kyrsimet tona

U kthyen njerzit ne milingona

Vdesin cdo dite me miliona

Kur banka gjoja falimentone

Shteti me te shpejt i ndihmone

Taksat e popullit harxhone

Dhe banka emrin ndryshone

Po na shpiken dhe Globalizmin

Dhe luftuan Komunizmin

Per te share Centralizmin

Vune ne jete egoizmin

Globalizmi si parime
Centralizm ne komandime
Per pakicen ne sundime
Dhe shumicen ne skllaverime

Vet e shpiken dhe komunizmin
Eksperimentuan centralizmin
Vete e pollen dhe Nazizmin
Per ta perhapur globalizmin

Iluminatet superior
Duan nje rende te ri boteror
Te shtrenguar ne nje dor
Me deshir a me teror

Kerkojne Qeveri boterore
Qe te jet reformatore
Gjoja barazi shoqerore
Si baktit ne thertore

Mesjeta plot lufte e shkaterrime
Pape e Mbreter me komandime
Kryqezatat mbollen plot mjerime
U dogj cdo gje ne flake e pervelime

Shpiken bible e kurane
Per te komanduar dynjane
Boten ne erresire e lane
E mbuluan me shafrane

Poshte keshtjelles ne Vatikane
Sekretet e botes aty jane
Jane mbuluar me tejmane
Kush tregon gjen belane

Papa vet zoti shtepise
Rruan misteret e lashtesise
Nuk do njeri qe ta bezdise
Se del hile e tradhetise

Dhe Pirate behet Pape
Ne fron ulur i ber tape
Gjith te tjeret i bene zape
Biblen tunde si qitape

Te gjith Papet ne Vatikane
Kane ngrenee buke ne nje sahan
Shumica kane qane rrufjane
Turpi i botes ane e mbane

--- III ---

Nisin luftrat shkatrimtare
Me qellime grabitqare
Per te vjedhur ca thesare
Ti vulosin ne hambare

Luftrat behen per fitime
Mafia shet armatime
Tregu bene spekullime
Mbushet bota me mashtrime

Shkojne ne paqe per bisedime
Mbrapa perdes spekullime
Gjuhe neperke me mashtrime
Sflasin kurr me arsytetime

Kush e sill boten verdall
Jane Cifutet me kapistall
Ata vet e kan nje hall
Gjith floririn e duan mbi ball

Zanafilla e cdo lufte
Ka brenda djallzin cifute
Lind si kerkese akute
Kerkon zgjidhje absolute

Me e vjetra lufte e Trojes
Nuk u be per fjalet e gojes
Qe mbulon shkakun pasojes
Shkruar me te zezen e bojes

Gjoja sebep tradhetia
Nga Helena bukurija
Shkaku ishte pasurija
Te grabitej nga fqinjësija

Epoka e bronxit po mbaronte
Ajo e hekurit po fillonte
Vetem Troja po e gezonte
Per cdo dite po lulezonte

Teknologjine ajo zoteronte
Neper vite po perparonte
Boten mbar po kontrollonte
Hambaret me flori po shtonte

Mbreti I mbreteve Aga Memon

Gjith te tjeret I udhezoi

Qe te rime per jete ne fron

Na duhet floriri me ton

Qe nga Sparta ne Mikene

U mblodhen ku do qe qene

U betuan dhe bene bene

Ne Troje do mbushim qesene

Dhjete vjete u pregatiten

Po aq vite u ropiten

Gjersa Trojen e zhuriten

Gjith floririn e grabiten

Po na shpiken kalin e drurit

Vune ne jete djallezin e trurit

Te vertetes brenda qivurit

I vune larte pllaken e gurit

Qe te kete jete dinakerija

Do shkruar ndryshe historia

Te mos e kuptoi njerzia

Se u duhet prape djallezia

Me tradhti eshte mare Troja
Genjeshtrat qe u thane nga goja
Me vones u doli boja
Tremije vjete nga pasoja

Helena veproje nga brenda
I hapi portat e renda
Te veshur me flete argjenda
Ashtu si shkruane dhe legjenda

Ne cdo kohe keshtu ka ndodhur
Pasuroheshin pa u lodhur
Ta mernin grurin te korur
Benin shkak nje mize te ngordhur

Nuk ka rastesi ne kete Bote
Cdo gje e kurdisur me komplote
Nga ata qe sunduan dije e sote
Qe hambaret e tyre ti mbajne plote

Egjith bota keq eshte mbarsur
Njemije veta ka te pasur
Shtat miljarde buze plasur
Permbi gur koken perplasur

Bote e ndyre bote e palare
Ligjin bejne ca kusare
Skan te ngopur as ne vare
Hane si krimba cdo lloj fare

I pasuri behet senatore
I mencuri ngelet i gjore
Senatori te ka ne dore
Te vrete e te shpalle deshmore

Shumica punon e prodhone
Por cdo dite agjeron
Pakica gezon e shijone
Cdo dit me avion fluturone

Te keqen se dime nga vjene
Se krijojne ca Bin Ladene
Hane nga brenda dyshemene
Te verteten dot se gjene

Per 10 vjet nje Bote e tere
Qepen gojen me gjelpere
Bin La Deni gjate e gjere
Bente plazhe permbi rere

Po krijuan ca alibira
 Vune ne jete idet e ngrira
 Terorizmin nga eresira
 E nxuar vete ca egersira

Popujt i ka zene belaja
 Nga dinastite e medhaja
 Mendjen e kane te paraja
 Mu ne koke u rente damllaja

Kush i shkele ligjet e botes
 E marte plumbi prapa kokes
 Kush i ve gurrin rrotes
 E gezoft arken e gropes

-- IV --

Bota mbushur plot mistere
 Brenda zjene ci kazan sere
 Jashte lyer me gelqere
 Si shtepite per dite vere

Lulezon pluralizmi

Politika si hipizmi

Me kalorse servilizmi

Plot me vlera idiotizmi

Korupsioni dhe imoraliteti

Vene e vine si dallge deti

S'duan t'ia dine cthote mileti

Frike kan vetem nga termeti

Ky termet dot spo vjene

Se popujt gjume po flene

Helem e pine te shkret kafene

Per cdo dite mbi xhenazene

Ne kete bote te perzjere

Vetem dija duhet te kete vlere

Te mencurit te mos haron asnjhere

Brezat ti kujtojne per here

Ata qe kane mendje shume

Ti vendosim ne tribune

Qe te bejne urat mbi lume

Popujte mos ti lene ne gjume

Bota ka dhe ca te mira
Doli shkenca nga erresira
Kaloi neper rruge te ngrira
Pruri dije nga hapesira

Sherbertoret e Metafizikes
Kishin mbjell ndjenjen e frikes
Dolen ligjet e fizikes
Qe leshuan rrezet e drites

Filozofet e lashtesise
I dhane dije njerezise
Hapen portat e gjithesise
Nxoren ligjet e “Yllesis”

Republika e Platonit
Eshte simbol i Etalonit
Nuk ka vlere numri i kartonit
Se sa dija e ypsilonit

Se kjo vota me kartone
Neper xhepa avullone
Si gjinkalla kur kendone
E mer erra dhe fluturone

Filozofet si Sokrati
Rralle here i bije sahati
Qe nga goja i rridhte mjalti
Ne kembe ngrihesh dhe sakati

U hodhe themeli i betonit
Dolen ligjet e Njutonit
U hape rruga e atomit
Fluturuam drejt ozonit

Me teleskopin e largesise
Ish pioneri i Astronomise
Hapi rrugen e diturise
Koperniku i Polonise

Dhe Anjshtanji fizikante
Me i ndrituri si brilante
Shkences i ndoli garante
Si dijetar dhe i vecante

--- V ---

Dhe Ballkani pjese e botes
Gjendet ne juge te Evropes
I vjeter sa mosha e tokes
Ndodhen sot ne fund te gropes

Ka qene ndere ne lashtesi
Ka lene gjurme ne histori
Eshte dalluar per mencuri
Ka shkelqyer per trimeri

Problem kemi sote Greqine
Qe ka ne gjake dinakerine
Do te mohoje historine
Do e para ne origjine

Greket e pare ishin Gjermane
Me prejardhje Indo Europiane
Te ardhur qe heret ne Ballkane
2500 vjete para vitit Kristiane

U perzien me popullin Pellazgian
Si kombi me i vjeter Europiane
Stergjyshet e fiseve Iliriane
Qe historin te shkruar e kane

Greket e sotem jane te ardhur ne Ballkane
Origjinen nga Egjypti e kane
Nje pjese jane Asiriane
Dinakrin ne gjake e kane

Sic ka shkruaur Homeri ne leter
Ne gjith Boten kohen e vjeter
Nuk permendet fjala greker
Keta te sotmit jane gje tjeter

Greket e vjeter ishin te zgjuar
Keta te sotmit te shartuar
Nga mendja jane te harbuar
Jan Shovinist te terbuar

Me fqinjet nuk shkojne kurr mire
Gjumi si ze per Vorioepire
Endra shikojne me vampire
Cdo gje e duan me pahire

Pasi kane marre Camerine
Kerkon te ndaje dhe Shqiperine
Mese per mese me Serbine
Qe te dyja buzet lepijne

Ne mijevjecaret e historise
Shkelqehu forca e Ilirise
Nga universitet e diturise
Prej Durhait e Apollonise

Kur erdhen sllavet e Serbise
Prej uralave te Siberise
Ne brigjet e Ballkanise
Shqiptaret ishin zotet e shtepise

Sllavet e pare ishin kanibale
Egersira per ne male
U versulen si vandale
Vetem deti u tha ndale

Pa dyshim qe Pellazgjia
Me e vjeter nga gjinia
Kaloi lumin si gjemia
Pruri dije nga Azia

Sipas dijeve te mia
Si dhe shkruan historia
Me e vjetra nga lashtesia
Na qenka Mesopotamia

Nga kjo kulture e pare ne bote
Eshte Iraku qe kemi sote
Nuk ngjane me te parin qe mote mote
Se eshte bere per te qare me lote

Egjypti eshte I dyti si qyteterime
 Vetem buze Nilit kish gjelberime
 Piramidat ndertuan me perkushtime
 Gjeometrin e vune ne zbatime

Miliona skllever punojne per Faraone
 Thaheshin ne diell cdo dite si rigone
 Per nje jete te lire mendja u fluturone
 Por dhuna cdo dite plaget i lendone

Greqia e lashte eshte e treta
 Duallen mendje te mprehta
 Qe zbuluan shume te verteta
 Plote me vlera ne kohet e veta

Diturija u shkruajte ne karta
 Greqia u ngjyrose ne harta
 Qytete te lavdishme si Sparta
 U gdhenden me germ a te arta

Qyteterimi I katert eshte Romake
 Aristokratet si shpendet ne cardhake
 Gladiatoret luftonin me tokemake
 Koloseu mbulolesh me gjake

Senatoret vrisnin Perandore

Jul Qezari u be therore

Bruti u shpalle tradhetore

Lufta behesh per Kurore

Dy fjale per besimet njerzore

Historia ne fillim ka qene gojore

Me vone u be shkronjtore

U vu ne baza shkencore

E gjithë Bota ane e mbane

Ne fillime ka qene Pagane

Natyren kishin me prane

Besonin te gjithë vecane

Per kete Toke e kete gure

Per kete Diell e kete flamure

Thoshin Paganet qe kure

Se nuk ishin pa kulture

Ateizmi fron per Mbreter

Eshte shkence e shkruar ne leter

Ardhur qe nga koha e vjeter

Nuk besonin ne Boten tjeter

Kush ka dale prap mbi vare
 Le tna thote cfar ka pare
 Se une do digjem ne zjarre
 Qe kjo Bote te gjeje karare

Reth dymije vjete me pare
 Lindi centralizmi pare fetare
 Jezu Krishti u vu I pare
 Idete e tija nuk kane te share

Me vone prape u percane
 Ne katolik ,Orthodoks e Kristian
 Nga ana tjeter Mysliman e Bektashian
 Qe te gjithe nje qellim kane

Dhe per fene jane berre gati
 Ka dale ne skene Iluminati
 Eshte kurdisur si sahati
 Qe te haje si lugati

Ata qe kane shpikur fene
 Kane menduar dhe per rrufene
 Ta leshojne mbi teqene
 Po jua prishe pak midene

Feja eshte e mire si morale
Te pasurit e perdorin per capitale
Te varferit e kane si ideale
E verteta do shekuj te dale

Me respekte per besimtaret
Une anoje nga shkenctaret
Qe radhiten nder te paret
Ndricojne Boten si fanaret

Nuk e dime se ku do ishim
Sikur keta te mos kishim
Neper pyje do te riteshim
Lekure peme do te vishnim

--- VI ---

Vargjet botes do ti thure
Ajo dergjet e semure
Po lengon ne temperature
Nuk ka per tu sheruar kure

Kush e ka sunduar Boten
Per kete toke u perloten
Jane ata qe mjelin lopen
Po I ngave ta bejne gropen

Ata nuk i njohe as une
Se nuk dalin ne tribune
Rrine si gjarperi nen gune
Dine te bejne te liga pune

Droga, sida bejne kerdine
Nenat qajne e ulerijne
Ku po e cojme njerezine
Kush do ta mbroje fatezine

Ku na eshte Perendia
Po na vdese pa lere femia
Ku po shkone shoqeria
Na mbuloi ligesia

Po na vrete vellai vellane
Djali nuk e do babane
Vajzat nuk degjojne mamane
Duan pleqe per Jarane

Popujte duhet te mosojne
Nga vine e ku shkojne
Kush jane e per ke punojne
Boten ta dekospirojne

Keta te pasurit shume mendohen
Per kete popull pergjerohen
Kot e kane qe mundohen
Vaj e uthull nuk bashkohen

Para meje ka te tjere
Plot me dije e me vlere
Qe fyturen ja kan cjere
Kesaj bote te perziere

Po kujtoj Viktor Hygone
Me “Te Mjeret” na ngushellone
Po ashtu Leon Tolstone
Me “Ringjalljen” na trishtone

Kemi edhe Xhek Londone
Zemrat tona na lendone
Ku sistemin dekospirone
Te vertetat kur tregone

Dhe Shekspiri me tragjedite
Qe zbuloi dinakerite
Nxori ne shesh gjith ligesite
Qe trashgojne Mbreterite

Dhe Honere De Balzake
Shkruajti per Europen plake
Plaget e vjetra kullojn gjake
Edhe sote neper sokake

Keta kollose te letersise
Ishin ajke e shoqerise
I bene mbrotje vegjelise
Nga kthetrat e Tiranise

Ne dy sisteme kame punuar
Ne dy kontinente kame jetuar
Djersen lume e kame kulluar
Shume nga jeta kame mesuar

Per te gjitha sa kame shkruar
Me keto vargje te levruar
Te verteten kame treguar
Ashtu si e kame menduar

Kur mesova historine
Vargje shkruajta per njerzine
Te verteten le ta dine
Edhe brezat qe do vine

LABERIA

(Poeme)

I

Do te shkruaj per Laberine
Maj malesh vetetine
Ne cdo ane qe ka kufine
Shkelqen vesa mbi trendeline

Dielli mbi maja ndricone
Bilbili ne pyll kendone
Thellenza kur vjene e shkone
Perplas krahet e fluturone

Anes Vjoses kur kalone
Uje i ftohet gurgullone
Cobani me dhen po shkone
I bije fyellit kur ndalone

Ja dhe vashat mbi lendine
Plot me lule kane shamine
Kuvendojne per dashurine
Ku ta gjejne ato e dine

Te cezma poshte ne krua
Vjen bandilli i verdhe si ftua
Nje nga vashat do per grua
Hajde mike se une te dua

Ne lugina kocimare
Ulen delet si manare
Mendja te iken per fare
Kur degjon cilen dyjare

Ti moj Laberia trime
Rrite djeme me therime
Pa uje e me agjerime
Nate e dite ne enderime

Kur kushtrimin jep Atdheu
Ngrihet labi si Promoteu
Zjarrin ndese me suferine
Male e fushat vetetine

Laberi o vend i rralle
Flake nxjer nga cdo stralle
Per cdo trime me ylle ne ball
Qane nena me shume malle

II

Kush jan trimat e Laberise
Drite e jete i dhan lirise
Fame te madhe Shqiperise
Legjendar te historise

Nuk te mposhti pleqeria
Selam labi Salaria
Shkelqeve nga trimeria
Qe te zhdukesh roberia

Ne male me suferine
Kanan Maze sokelline
Ta debojme Italine
Jemi vete per Shqiperine

Me jelek e me qillota
Kanan Mazja ish nga Kota
Luftoi ne male e gropa
Ta marre veshe gjith Europa

Kapedan Sali Vranishti
 Ndrin si ylle prej fildishti
 Zigur Lelo trime me flete
 Si dragua malit perpjet

Dhe Halim Xhelo i pare
 Publicist dhe Atdhetare
 Mendje dritur dhe dijetare
 Vlore ndricoi si fanare

Ne Bejun u mor vendimi
 Italis ti behet zgjimi
 Do ta coj Mehmet Selimi
 Nga Mallkeqi krye trimi

Sic tregon Selam Mexhiti
 Piacetinin¹ ne kembe e ngriti
 Ultimatumin ja verviti
 Spranon Vlora, race hibridi

1- Gjenerali i ushtris Italiane ne luften e Vlores, 1920.

Ne Tragjas zonja Cure
 Veshur si burre me poture
 Mban ne breze dy kobure
 Heroin nure mbi nure

Asim Zeneli trim i ralle
 E desh nena djale te gjalle
 Ai dha jeten per vatane
 Armiku zgjeti dermane

Mustafa i Matohise
 Ish bilbil i Laberise
 Ndricoi mendjen vegjelise
 Dha kushtrimin e lirise

Pena si pushk gjemoje
 E pushka si pen vajtoje
 Mustafaj jeten ndroje
 Shqiperia te lulzoje

Qe kur linde ne Picare
 Der sa shkove vet ne vare
 Ne tre sisteme legjendare
 Shefqet Pec o komndare

Gjeneral i Laberise
 Zhvilloi greven e urise
 Ne burgun e demokracise
 Lamtumire i tha lirise

Bejtexhi dhe patriote
 Xhebro Gjika qane me lote
 Duam Vloren se leme dote
 Do luftojm ti dalim zote

Hysni Kapo te nderone
 Si shqiponj kur fluturone
 Male e fusha zbukurone
 Goja mjalte kur ligjerone

Hysni Kapo bukuria
 Djale levend nga laberia
 Dallonte nga mencuria
 Ne balle e kish diplomacia

O Zgalem i Laberise
 Ckujtim i late rinise
 Ti hape portat diturise
 Ti rise nderin Shqiperise

III

Ne Drashovice fillon Laberia
 Qe aty nise bukuria
 Breze mbas brezi trimeria
 Neper shekuje besnikerija

Kallarat Kuc e Bolene
 Burrat pushken grate qesene
 Jane trima tundin dhene
 Ta kendojne meselene

Kur kalon nga Ramica
 Kembe kryq te gorica
 Zog i skuqur me rosnica
 Ta ben trupin me mornica

Te Safai ne Progonate
 Behet dasem dite e nate
 Ne gosti i tere nje fshate
 Hane e pine e s'bejn shamate

Me bardhake pihet rakia
 Dehen burrat nga dollia
 Nxiren jashte te avllia
 Ne mengjes sa tu dal pija

Djale marton Safa Imeri
 Dridhet hoda gur mermeri
 Mishrat varur te cengeli
 Te perbrendshmet te qemeri

Dollibashi me lezete
 Dolli e sini ta kete
 Plot shendete e shume kismete
 Qe te gjitha i duan pervete

Fshati i bukur moj Smokthine
 Historia ne balle te ndrine
 Shushica me gase oshtine
 Melodine per trimerine

Musaraj me poezine
 Bukur shruajti historine
 Si per Ballin dhe Partine
 Dhe per gjithe Shqiperine

Kush shkone mik ne Vranishte
 Merre nishane permbi bishte
 Mishi i pjekur rakia shkume
 Isua labe te ve ne gjume

Mjelle i bardhe per cyreke
 Dhalla rihet ne dybeke
 Lakra te egra per byreke
 Plot me shije kur ha dreke

Romsi qan Aredine
 Gjermanet i dogjen shtepine
 Se ce vran dhe fatezine
 Si pasqyre kujtimi ndrine

Me vjen keq per Kocule
 Vdiq Qazimi¹ per nje vule
 S'hante mish por donte pule
 Italianet i futen shule

Xinxinfillja ne Armene
 Qendron ulur mbi sergjene
 Shikon djalin kur kercene
 Ja kupton isharene

1- Qazim Koculi ish exponent i Ballit Kombetar, pushkatuar nga Italianet.

Larte e poshte ato qepalla
 Sec i pa dhe zonja halla
 I nxjerre fjalet nga dhemballa
 Ti marr veshe gjithe mehalla

Ujet e ftohte ne Tepelene
 Mbahet mende per kos qesene
 Cobanet zbresin kopene
 Ne hije te rapit pijn kafene
 Po i ngave ta bejn bene

Qe nga Vlora ne Dukate
 Mban me vrap tre sahate
 Burat ulur mbi sofate
 Buza gas te presin grate

Jane te holle ne muhabete
 Llogaria ne kulete
 Plot hambar dhe bereqete
 Bejne ashtu si duan vete

Per Tragjas e per Radhime
 Do te shkruaj me perkushtim
 Se jane pjese e vendit time
 Do i kujtoj me mallengjim

Per Lekdush e per Gusmare
 Per Kolonj e per Picare
 Kenges labe do tja mare
 Le te dal flaka mbi zjare

Laberia pa Tepelene
 Si shqiponja pa folene
 Reze malit kur e gjene
 Historin te refene

Tepelen qytet i erese
 Hapi portat e keshtjelles
 Qe te hyje flladi i pranveres
 Te degjosh zerin e shqeres

Tepelena e Aliut
 C'ti kujtosh fateziut
 Veshur qyrkun e ariut
 Bente ligjet e Kadiut

Tepelena e Selamit
 Amanet c'i la djalit
 Te mari vrapin e kalit
 Te ngjitet ne maj te malit

Tepelenen ta vrojtoje
 Nga armiqte le ta ruaje
 Te mos shkeli kembe e huaje
 Qe Laberia te mos vuaje

Tepelena reze malit
 Nuseron si nuse e djalit
 Me duvake ne maje te kalit
 Si flori ne mes te ballit

Ka dhe burra per kuvende
 Se kane mendje te argjende
 Ne cdo kohe ze fjala vende
 Kur punon per vendin tende

Kush eshte zemra e laberise
 Perkrenare e trimerise
 Udhe refyese e historise
 Kurvelesh i djalerise

Kurvelesh te qofsha fale
 Rrite breza per ne male
 Luftuan e mbrojtjen vatane
 Driten e syve ata dhane

Bilbilejte te nderuan
 Historin me gjak e shkruan
 Ne cengel varen draguan
 Per mbi koke i vune patkuan

Mesapliku ne lugine
 Plot me lule trendeline
 Dele e shqera blegerine
 Ujku ne male ulerine

Zonja e shpise fshin avlline
 Vet i zoti gezone shtepine
 Miq e shoqe kurre i vine
 Buza gas u nxierre rakine

Ne cengel varur kusine
 Qengji i pjekur era vine
 Me byreke mbushur carkine
 Revania plote sinine

Kurvelesh e Mesaplike
 Cdo keshtjell nje ciflike
 Me kanun te prët si mike
 Po e shkele te ben armike

Mikpritja dhe Bujaria
 Vlersohet sa gjithë shtëpia
 Respektohet gjitonija
 Mbi të gjitha miqesija

Eshtë e shtrenjte besnikerija
 E vjeter sac është Laberija
 Kush e shkel nga diallezija
 Denohet nga gjith shoqerija

Dele hena për të zhdukur
 Iken djelli për të dukur
 Kurvelesh o vend i bukur
 Në çdo lule ke një flutur

IV

Dallandyshe krahe shkruar
 Të nisa që pa aguar
 Male fusha ke kapetuar
 Në vendin tim ke qendruar

Bilbilit i conit fjale
 Te kaloj lumin me vale
 Kengen kur te mos e ndale
 Te kendoj male me male

 Te kendoj per Laberine
 Mengjes e dark per trimerine
 Per cdo dite per bukurine
 Lart ne qiell si ylli ndrine

 Mbi tre ura eshte Laberija
 E vjeter sa eshte njerzija
 Me themel eshte mencurija
 Mbi te gjitha eshte trimeria

 Pushke e pene si kane ndare
 Ne cdo vende dalin te pare
 Te betuar gjere ne vare
 Spunon LABI yzmeqare

 Neper malet e Laberise
 Degjohen zerat e perendise
 Urim i bejne Shqiperise
 Te ndjeke rrugen e begatis

O ju male me debore
 Aleat me pushke ne dore
 Mjergullen keni si kurore
 Si githmone triumfatore

Kane dale malet ne valle
 Kendojne kenge ne festivale
 Laberi derte me halle
 Zjarre i ndezur ne mangalle

Laberi trimat ci ngjalle
 Duall si flake neper steralle
 Hodhen gunat mbi peralle
 Morren rrugen larte mbi zalle

Laberi me male shume
 Mos e vere syrin ne gjume
 Se te shkone puna per lume
 Nuk jetohet ne bodrume

Per ju male kendoj Naimi
 Zemer plasur nga trishtimi
 Vendin kish mbuluar mjerimi
 Nuk kishe ardhe akoma zgjimi

Per ju male nga mergimi
 Zemer zjarre nga mallengjimi
 Po kendoje nga ngazellimi
 Ngjyre te kuqe cele agimi

V

Ne thesarine e historise
 U fute kenga e laberise
 Male me mal e lise me lise
 Bilbili kenges ja nise

Iso mban gjith laberia
 Tunden odat dhe avllia
 Luajne tjegullat nga catia
 Ikin zogjet nga xhelozia

Si ujvare zbrete nga mali
 Kendon vasha kendon djali
 Kendojne burat te litari
 Iken dimri vjen behari

Bilbilejte te trembedhjete
 Kenges se cja moren vete
 Se ishin trima me flete
 Qe tronditen nje dovlete

Nga bejleret e Cepratit
 Vjen ferman i Sultan Muratit
 Bilbil Shako Komandantit
 Te varet te dege e Rapit

Dale Beje te them dy fjale
 Amanete do le per djale
 Te behet trim me palle
 Qe tju fuse ne grope te gjalle

Te ma beje varin Kamine
 Te digjem per Shqiperine
 Bashke me eren suferine
 Te hedhe hirin ne tere Laberine

Kush kendoj Bejken e bardhe
 Tundi malet radhe – radhe
 Ishte Piluri kete radhe
 Qe na dha komposto dardhe

Dalin dhente para cobanit
 Bashk me to e zonja e stanit
 I gezon zemra e xhanit
 Kur zberthen kopsen fustanit

Ne Bencaj ne Tepelene
 Nis kenga dhe mer dhene
 Kalone Dorzen nen teqene
 Pershkone teje myzeqene

Kur arine ne fushe Dumrene
 Si kalores me kallogrene
 Kthehet prape ne Tepelene
 Filli i kuqe per Memedhene

Fyellit se ci bie cobani
 Po bien gjethet nga mani
 Me degjo moje Tane xhani
 Hajdutet kane ardhur te stani

Cfare i pane syte Janines
 Permes drites te vetetimes
 Vrane pashane e Kostandines
 Kendon grupi i ulerimes

O ju djemte e Lapardhase
Ju shkoi nami ne fund te dynjase
Kendone zemra me maraze
Historine qe lame pase

VI

Moj e mira histori
Shkruai geramat me flori
Legjendaren laberi
E bekoi nje perendi

Te gjithe ta doni laberine
Vete zoti i dha bukurine
Ne shekuj i shtoi dhe trimerine
Te rise ndere e krenarine

Kush shane Laberine
Ka zemruar vete Perendine
Dy gure bashke nuk do rine
Sa te gjejne urtesine

Hapa dritare dhe dere
 Erdhi era luleshqere
 Laberi lule me ere
 Pranvera qe sjelle pranvere

Laberi yje mbi male
 Ke ne zemer nje ideale
 Per cdo stine me te dale
 Nga c'do shkemb del nje djale

Laberi fole shqiponjash
 Ne per gryka kenge jehonash
 Si statuje ne mes ikonash
 Qendisur me dege limonash

Laberi o zemra ime
 Pena shkruan me ligjerime
 Ujte e ftohte ne ato burime
 Mbane te gjalle kujtesen time

Laberi madem floriri
 Une po tretem si qiriri
 Zemra po me dele nga gjiri
 Kam dhe malle per lule bliri

Laberi shkembe mbi male
 Cdo cobane nje gjenerale
 Nga ai shkembe dhe un kam dale
 Do te vdese me ideale

Ne ato male ne ato stane
 Rrine cobanet me llabane
 Laberi moj kapedane
 Vetetima ne tufane

Moj e shkreta nostalgji
 Qe me rri brenda ne gji
 C'me trete me bere hi
 Per te shtrenjten Laberi

Laberi qofsh e bekuar
 Sjelle ne mend kohen e shkuar
 Rri ne shtrate i menduar
 Per cdo nate syrin zgjuar

Parathenie-----	03
Hyrje -----	13
Mergimtari -----	15
Shqiperia ime -----	19
Nene moj me ka marre malli -----	34
Malli per Memedhen -----	37
Kosova -----	44
Camera -----	46
Europa -----	48
Respekt per brezin tim -----	52
Pavarsia -----	58
Shqipetaret e Amerikes -----	61
Dhelperia -----	64
Njerze te liq -----	67
Viti I mbrapsht -----	75
Otranto 97 -----	77
Pseudohistorianet -----	80
Hipokriti -----	84
Ali Pasha -----	86
Vace Zela -----	91
Dritero Agolli -----	93
Mbretit Zagollian -----	96
Gjembaci -----	99
Gjirokastres -----	102
I pa haruar -----	105
Enver Hoxha -----	107
E bukura e dheut -----	111
Historia e vlores -----	115
Ku Kam Ler -----	121
Babai Im -----	124
Fshati Sevaster -----	128
Per Gorrishtin -----	129
Nostalgji per Fierin -----	134
Nena labe -----	140
Malet e Vashes -----	143
Natyra -----	146
Bota ne vargje - POEME -----	151
Laberia POEME -----	178









